



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/31;
Datë: 30.01.2015 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-004-M48	2	04.02.2015

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 001/19, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.01.2015 nxjerrë:

V E N D I M

për

formimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut

- I. Me këtë vendim themelohet Komisioni për Përzgjedhjen e Stemës së Komunës së Junikut /në tekstin e mëtejme komisioni/.
- II. Komisioni ka për detyrë që t'i respektojë të gjitha procedurat ligjore deri në miratimin e stemës nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut siç janë:
- II.1. Përpilimi i kriterëve për dizajnimin e stemës së komunës,
 - II.2. Vlerësimi e aplikacioneve në mënyrë anonime,
 - II.2. Përgatitja e listës së ngushtë pasi të kryhet procesi i përzgjedhjes,
 - II.3. Bërja e konsultimeve të gjëra publike lidhur me propozimet që janë në listën e ngushtë,
 - II.4. Përzgjedhja e stemës dhe propozimi në kuvendin e komunës për miratim, etj. .
- III. Për mbarëvajtjen e punës së komisionit, i njëjti harton: planin e punës dhe raportin e punës.
- IV. Të gjitha projekt dokumentet nga pika III. e këtij vendimi i procedohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.
- V. Projekt plani i punës së komisionit me kosto financiare duhet t'i procedohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim më së largu 30 ditë pas konstituimit të tij.
- VI. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Nga një (1) anëtar nga secili subjekt politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Junikut dhe një (1) anëtar nga ekzekutivi i Komunës së Junikut.
- VII. Propozimet nga pika VI. e këtij vendimi duhet t'i bëhen kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Junikut më së largu 10 ditë nga dita e miratimit të këtij vendimi.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>

VIII. Komisioni është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Junikut.

IX. Mbledhjet e komisionit i udhëheqë kryetari i komisionit i cili do të zgjedhet në mbledhjen konstituive të komisionit.

X. Kryetari i komisionit zgjedhet sipas nenit 8 paragrafi 8.7 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

XI. Puna e komisionit fillon me konstituimin e tij dhe përfundon me miratimin e stemës së Komunës së Junikut.

XII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar deri më tash.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. MAPL;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>